



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORT MBI VETËDEKLARIMIN E AUTORITETEVE PUBLIKE PËR ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT PËR VITIN 2025



www.idp.al

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
METODOLOGJIA	4
ANALIZA E TË DHËNAVE DHE GJETJET KRYESORE	5
PËRFUNDIME.....	11

HYRJE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka realizuar për të dytin vit rradhazi procesin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave mbi zbatimin e detyrimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”) nga autoritetet publike shqiptare (në vijim “AP”). Përmbushja e këtyre parashikimeve rregullatore është përcaktuar në nenin 24/1 të tij - “**Detyrimi për bashkëpunim**”, i cili parashikon, se:

1. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.
2. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.

Në zbatim të këtij detyrimi të LDI, me Urdhrin e Komisionerit nr. 1, datë 05.01.2026 “Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike për vitin 2025 mbi zbatimin e kërkesave të ligjit “Për të drejtën e informimit” (në vijim “Urdhri nr. 1/2026”)¹ u realizua ky proces. Me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, Zyra e Komisionerit synon që të ketë informacion sa më të saktë dhe të plotë mbi zbatimin e LDI, por edhe mbi problematikat që mund të kenë hasur AP/koordinatorët për të drejtën e informimit apo kërkuar (qytetarët, OSHC, media, etj). Fotografimi i situatës sipas këtij formati të standardizuar evidenton prirjet mbi natyrën e kërimit të informacionit/dokumentacionit me karakter publik, mënyrën dhe kohën e trajtimit të tyre, rastet dhe shkaqet e përdorura për kufizimin e dhënies së informacionit, si dhe atje ku është e mundur identifikimin dhe kategorizimin e kërkuarve.



¹https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/1.Urdher_vetedeklarimi_AP_2025.pdf

Nëpërmjet këtij procesi raportues, bashkëpunimi i AP sipas përcaktimeve të nenit 24/1 të LDI përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm për adresimin edhe të qëndrimeve të partnerëve vendas apo ndërkombëtarë, që monitorojnë veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit ndër vite. Siç është edhe rasti me raportin e UNCAC për vitin 2025 (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Korrupsionit), ku theksohet, se:

Rekomandohet që Shqipëria të sigurojë që detyrimet e raportimit vjetor të prezantuara së fundmi nga organet publike në lidhje me zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë dhe të adresojë rastet e ardhshme të refuzimeve të parregullta për të dhënë informacion duke forcuar sistemin për mbikëqyrjen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të kërkesave për informacion (neni 10 (a) dhe neni 13, paragrafi 1 (b))².

It is recommended that Albania ensure that the recently introduced annual reporting obligations of public bodies related to the implementation of the Laë on the Right to Information are effectively implemented in practice and address future instances of irregular refusals to grant information by strengthening the system for oversight by the Commissioner for Information and Data Protection of information requests (art. 10 (a) and art. 13, para. 1 (b))³.

Garantimi i një mjedisi me kushte sa më optimale për ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim nga qytetarët apo grupet e interesit përbën përmbushjen e qëllimeve të LDI nga çdo autoritet publik.

“Raporti mbi vetëdeklarimin e autoriteteve publike për zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025” (në vijim “Vetëdeklarimi AP 2025”) është një dokument në funksion të forcimit akoma edhe më shumë veprimtarinë mbikëqyrëse dhe monitoruese të mekanizmave e procedurave për njohjen e qytetarëve apo grupeve të interesit me informacionin/dokumentacionin me karakter publik. Paralelisht, ky ushtrim do të nxisë Zyrën e Komisionerit që në kuadër të veprimtarisë së saj ndërgjegjësuere të shtojë trajnimet në numër, dinamikë dhe të përmirësuara në përmbajtje, për zbatimin sa më gjithëpërfshirës të LDI, me fokus mbi ato problematika të evidentuara nga ky raportim apo edhe atyre të konstatuara gjatë hartimit të Indekseve të transparencës proaktive për vitin 2025⁴.

²Përkthim jo zyrtar nga Zyra e Komisionerit

³Teksti zyrtar në anglisht

⁴<https://idp.al/raporte-monitorimi-te-transparences-2025/>

METODOLOGJIA

Për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, gjatë muajit janar 2026 u dërgua pranë çdo autoriteti publik formulari i raportimit mbi zbatimin e kërkesave të LDI për vitin 2025. Të dhënat e agreguara janë marrë për **368** (*treqind e gjashtëdhjetë e tetë*) autoritete publike, numër ku është përfshirë edhe Zyra e Komisionerit, nga të cilët **355** (*treqind e pesëdhjetë e pesë*) AP, ose një nivel prej **96.5%** (*nëntëdhjetë e gjashtë pikë pesë*) e totalit, kanë sjellë përgjigje. Formulari i raportimit, ashtu si edhe një vit më parë, përmban **16** (*gjashtëmbëdhjetë*) pyetje, disa prej të cilave edhe me nënpyetje, për të identifikuar/saktësuar si të dhënat e përgjithshme të AP, si emërtesa, faqja zyrtare në internet, pasja e Programit të Transparencës, të koordinatorit dhe të dhënave të tij/saj të kontaktit, ashtu edhe ato me një natyrë më specifike, që kanë të bëjnë me prirjet e kërkimit të informacionit/dokumentacionit me karakter publik, identifikimin e kërkuesve, rastet e kufizimit apo përfaqësimi në proceset gjyqësore, etj.

Periudha raportuese është janar-dhjetor 2025 dhe pyetësi i plotësuar i është përcjellë në rrugë zyrtare dhe/ose elektronike Zyrës së Komisionerit brenda datës 31 janar të vitit 2026. Funkcioni mbikëqyrës që Komisioneri ushtron mbi autoritetet publike ka për qëllim forcimin e kulturës së transparencës së AP, rritjes së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre përballë kërkesave, nevojave apo egzgjencave të publikut, grupeve të interesit dhe medias. Në këtë kontekst, bashkëpunimi i vazhdueshëm i autoriteteve publike me Zyrën e Komisionerit përbën një nga aspektet më të rëndësishme në drejtim të garantimit të ushtrimit në praktikë të të drejtës për informim dhe përmbushje e qëllimeve dhe objektivave të LDI.

Plotësimi i këtij pyetësi me të dhëna të sakta dhe të përditësuara është një detyrim për çdo titullar të autoriteteve publike, apo çdo personi përgjegjës, në mënyrë që të vihet në dispozicion i gjithë informacioni i domosdoshëm për Komisionerin në kuadër të përmbushjes së kompetencave të tij ligjore. Të dhënat e mbledhura nga ky ushtrim ligjor janë të dhëna publike dhe si të tilla, ato përbëjnë informacion me karakter publik sipas përcaktimeve të LDI dhe ligjit nr. 33/2022 “*Për të dhënat e hapura dhe ripërdoirmin e informacionit të sektorit publik*” dhe publikohen në formën/formatin që i janë raportuar Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, të dhënat e koordinatorëve për të drejtën e informimit janë publikuar⁵ dhe/ose përditësohen edhe në portalin pyetshtetin.al, si dhe do të qëndrojnë të tilla për aq kohë sa ky funksion do të ushtrohet prej tyre.

Nga eksperiencia më shumë se një dekadë që Zyra e Komisionerit ka akumuluar, të dhënat e Vetëdeklarimit AP 2025, të kombinuara me monitorimin konstant të instrumenteve të Programit të Transparencës dhe Regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve, ashtu si dhe me Indekset vjetore të transparencës proaktive, japin një panoramë të zgjeruar të situatës së transparencës në tërësi, mbi integritetin e përgjegjshmërinë e tyre, elementë shumë të rëndësishëm në funksion të llogaridhënies dhe mirëqeverisjes nga autoritetet publike shqiptare.

⁵<https://idp.al/wp-content/uploads/2026/03/Lista-e-Autoriteteve-Publike-2025.pdf>

ANALIZA E TË DHËNAVE DHE GJETJET KRYESORE

Zyra e Komisionerit vlerëson angazhimin e të gjitha autoriteteve publike për plotësimin e të dhënave dhe thekson se përmbushja e këtij detyrimi nuk është një proces i tepërt dhe burokratik, por pjesë integrale dhe e rëndësishme e zbatueshmërisë së parashikimeve të LDI⁶. Neni 24/1 i tij përbën thelbin e besimit dhe bashkëpunimit mes AP dhe Zyrës, në mënyrë që monitorimi dhe mbikëqyrja rregullatore të realizohet me paanësi, integritet dhe përgjegjshmëri. Kultura e transparencës është një mjedis me standarde dhe praktika të mira, kultivimi i të cilave është detyrë e përbashkët dhe e përditshme, jo vetëm e Zyrës së Komisionerit, por në rradhë të parë e çdo autoriteti publik, e çdo titullari/drejtuuesi, e çdo nëpunësi/punonjësi publik, pavarësisht pozicionit në strukturën institucionale.

Në tabelën e mëposhtme janë të kategorizuara autoritetet publike sipas natyrës së funksioneve dhe hierarkisë shtetërore, për 355 që kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit (të dhënat për Drejtorinë e Shërbimeve të Trupit Diplomatik janë raportuar dhe integruar në ato të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, institucion ku u transferuan funksionet në fund të vitit 2025).

Tabela nr. 1: Të dhënat mbi kategoritë e autoriteteve publike

Kategoritë	Viti 2025	Viti 2024
Institucione qendrore (Presidenca, Kuvendi, Kryeministria dhe ministritë)	15	14
Institucione të pavaruara (kushtetuese ose të krijuara me ligj)	19	20
Drejtori të përgjithshme	24	27
Institucione të tjera varësie (ekzekutive), universitete, ente dhe urdhra profesionale	151	136
Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki, këshilla qarqesh dhe prefektura* [<i>*shtuar këto të fundit për efekt të natyrës së veprimtarisë së tyre, edhe pse janë AP në varësi të Këshillit të Ministrave</i>])	79	84
Institucione të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori)	38	39
Shoqëri tregtare (ku shteti zotëron shumicën e aksioneve)	29	31

Në bazë të të dhënave të përpunuara për vitin 2025, në raport me ato të 2024, mund të konstatohet se kemi rritje të numrit të kërkesave për informacion të regjistruara nga AP/koordinatori në Regjistër, apo me një shtesë prej **12%** (*dymbëdhjetë*) më shumë dhe rrjedhimisht, kemi një ecuri pozitive edhe përsa i përket kthimit të përgjigjeve, me **16%** (*gjashtëmbëdhjetë*) më shumë. Nëse

⁶Lista e AP që nuk kanë deklaruar të dhëna: Radio Televizioni Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Bashkia Dimal, Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Këlcyrë, Bashkia Krujë, Bashkia Memaliaj, Bashkia Malësi e Madhe, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier, Spitali Rajonal Korçë.

analizojmë dhe njëkohësisht, krahasojmë më me hollësi të dhënat e deklaruara rezulton, se ka një ulje të ndjeshme të numrit të kërkesave që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuara, ose me **43% (dyzet e tre)** më pak; ka rritje të numrit të përgjigjeve të refuzuara, ose **23% (njëzet e tre)** më shumë; ka, po ashtu, rritje të numrit të kërkesave të deleguara në një tjetër AP, ose **9% (nëntë)** më shumë. Të tjerë tregues me rëndësi të analizuar, janë subjektet e kërkesave, ku kemi një ulje të ndjeshme të kërkesave të drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile, ose me **32% (tridhjetë e dy)** më pak; ndërsa numri i kërkesave të drejtuara nga media/gazetarë ka një ulje të lehtë me **5% (pesë)**.

Tabela nr. 2: Veprimtaria e autoriteteve publike mbi zbatimin e legjislacionit për të drejtën për informim

Veprimtaria mbi zbatimin e LDI	Viti 2025	Viti 2024
Nr. total i AP ku u dërgua formulari i raportimit	368	355
Nr. i AP që kanë raportuar	355	351
Nr. i kërkesave për informacion publik, regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve	13029	11549
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë	11017	9289
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuara	390	688
Kërkesa të refuzuara	248	191
Kërkesa të deleguara te një autoritet tjetër	669	611
Kërkesa nga gazetarë ⁷	2979	3129
Kërkesa nga përfaqësues të shoqërisë civile ⁸	1051	1540
Kërkesa që kanë marrë përgjigje brenda 3 ditëve pune ⁹	4666	-

Në të dhënat e kërkuara për t'u raportuar për vitin 2025 është edhe ajo në lidhje me kthimin e përgjigjeve brendave 3 ditëve pune, çka përbën **36% (tridhjetë e gjashtë)** të totalit. Nëpërmjet identifikimit të kësaj të dhëne, konstatohet një prirje e AP për të qënë më efektivë në procesin e kthimit të përgjigjeve, çka vlerësohet nga Zyra e Komisionerit pozitivisht dhe përbën një praktikë të mirë që duhet nxitur për t'u përkrahur në të ardhmen nga më shumë autoritete publike. Vlen të nënvizohet fakti, se standardet e larta të transparencës në tërësi janë rezultat si i përgjegjshmërisë profesionale të nëpunësve/punonjësve, ashtu dhe i qëndrueshmërisë e funksionalitetit të strukturës institucionale.

Ndërsa, më poshtë kemi një sintezë të të dhënave të deklaruara mbi shkaqet që kanë çuar AP/koordinatorët në refuzimin, aksesin e pjesshëm apo kufizimin në dhënien e informacionit/dokumentacionit, në zbatim të nenit 17 të LDI. Zyra e Komisionerit konstaton, ashtu si edhe në dokumente të tjera të saj (Raporte Vjetore), se shpesh ka një vlerësim përtej

⁷Për aq sa mund të identifikohen

⁸Për aq sa mund të identifikohen

⁹E dhënë e kërkuar për t'u raportuar për vitin 2025

parashikimeve rregullatore për këtë element të ligjit dhe e mban vazhdimisht në konsideratë përfshirjen në trajnime të kësaj çështjeje.

Tabela nr. 3: Të dhënat e raportuara në lidhje me shkaqet ligjore të kufizimit/refuzimit të dhënies së informacionit

Kufizimet	Viti 2025	Viti 2024
E drejta për një jetë private/mbrojtja e të dhënave personale	79	43
Sekreti tregtar	15	20
E drejta e autorit	5	7
Sekreti tregtar/patentat	0	1
Siguria kombëtare	22	27
Parandalimi, hetimi dhe ndjekja e veprave penale	84	88
Mbarëvajtja e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor	27	3
Formulimi i politikave monetare dhe fiskale të shtetit	0	3
Barazia e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtja e procesit gjyqësor	27	9
Këshillimi dhe diskutimi paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike	2	22
Mbarëvajtja e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare	4	6
Të tjera*	41	162


Për Zyrën e Komisionerit është mjaft e rëndësishme që kuptueshmëria e LDI, sidomos, përsa i përket përcaktimeve të nenit 17, që detyron interpretimin e situatave të caktuara në kombinim me kuadrin ligjor specifik, të jetë mjaft e kujdesshme, rast pas rasti, proporcionale dhe natyrisht, shteruese në argumentim. Testi i interesit publik është udhërfyesi që duhet të mbajnë në konsideratë në çdo rast AP, koordinatorët dhe secili prej nëpunësve/punonjësve që janë të përfshirë në procesin e dhënies së informacionit apo dokumentacionit. Në këtë kontekst, konsolidimi i funksionimit të mekanizmave të transparencës, para së gjithash ato për transparencën proaktive, veçse konfirmon parimin se hapja është “rregull”, ndërsa kufizimet përbëjnë “përrjashtimin” në veprimtarinë e autoriteteve publike.

Në Tabelën nr. 3 vlen të analizohen arsyet “të tjera” * për refuzimin/kufizimin e dhënies së përgjigjes kërkuar, ku bien në sy “shkaqe” të tilla, si:

- kërkesa ka rezultuar e paqartë për llojin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar,
- kërkesa nuk është paraqitur në formën që kërkon ligji,
- është kërkuar nga AP të paraqitet një dokument identifikimi nga kërkuarësi,
- mosdhënie të informacionit/dokumentacionit për mungesë të nënshkrimit të kërkesës nga kërkuarësi,
- përsëritja e shpeshtë e kërkesës,
- nuk disponohet informacioni/dokumentacioni nga AP, por nuk është kthyer përgjigje për këtë.

Për Zyrën e Komisionerit është e rëndësishme që autoritetet publike t’u vijnë në ndihmë, gjithnjë, qytetarëve dhe grupeve të interesit në mënyrë që të realizohet maksimalisht qëllimi i LDI. Për të lehtësuar këtë proces, janë hartuar edhe modelet e formularit të kërkesës apo ankesës, në mënyrë që të standardizohet sa më shumë që të jetë e mundur mënyra e kërkit. Bashkëpunimi dhe besimi i ndërsjellë në binomin kërkuar-AP garanton rezultate të larta në ushtrimin e duhur në praktikë të kësaj të drejte individuale. Është, po ashtu, e rëndësishme të kuptohet, se refuzimi apo kufizimi në kthimin e përgjigjes duhet argumentuar ngushtësisht nga një apo disa prej përcaktimeve të nenit 17 të LDI.

Grafiku nr. 1: Numri i ankesave 2022-2025



Nëpërmjet shifrave të paraqitura në Tabelat nr. 2 dhe 3, Zyra e Komisionerit kërkon të kuptojë më shumë mbi prirjet e kërkuarëve, në mënyrë që të realizohet një kryqëzim të dhënash me numrin dhe cilësinë e ankesave që administrojnë dhe trajtojnë institucionet. Sipas *Grafikut nr. 1* më sipër, gjatë vitit 2025, ka ulje të numrit të tyre në raport si me një vit më parë, ashtu edhe me vitin 2023, çka për Zyrën e Komisionerit vlerësohet, se kjo prirje mund të shpjegohet me përmirësimin gradual dhe të qëndrueshëm të transparencës proaktive të autoriteteve publike. Prej numrit total të **897** (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë) ankesave të trajtuara, **861** (tetëqind e gjashtëdhjetë e një) janë të reja, ndërsa

36 (*tridhjetë e gjashtë*) të mbartura. Në referim të shifrave, kemi një normë prej rreth **7%** (*shtatë*) të raportit ankesa-kërkesa ($861 \div 13029$) për vitin 2025, ndërkohë që në 2024 ky raport ishte rreth **8%** (*tetë*)¹⁰.

Në terma të përmbushjes së detyrimeve të LDI, nga **897** ankesa të trajtuara gjatë vitit 2025, për **525** (*pesëqind e njëzet e pesë*) prej tyre, ose në **59%** (*pesëdhjetë e nëntë*) të rasteve, informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve gjatë procesit të shqyrtimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit¹¹. Edhe nëpërmjet shifrave të sipërpërmendura, konfirmohet qëndrimi tashmë i konsoliduar i institucionit mbikëqyrës se zbatimi korrekt i kuadrit ligjor, pikë së pari duke konsoliduar arkitekturën e transparencës proaktive, është rruga e duhur për të patur një administratë publike të përgjegjshme, etike dhe të hapur, qeverisje me integritet, funksionim të demokracisë.

Tabela nr. 4: Kategoritë e ankuesve

	Viti 2025	Viti 2024
Kategoritë e ankuesve	861 ankesa dhe %	939 ankesa dhe %
Qytetarë	388 ose 45%	393 ose 42%
OSHC	87 ose 10%	181 ose 19%
Gazetarë	386 ose 45%	365 ose 39%

Referuar Tabelës së mësipërme, rezulton se ankesat e administruara nga Zyra e Komisionerit edhe gjatë vitit 2025, në shumicë, në **55%** (*pesëdhjetë e pesë*) të rasteve janë depozituar nga gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile, ndërsa në **45%** (*dyzet e pesë*) të tyre nga qytetarë. Nëse bëjmë një krahasim sipas shifrave të Tabelës nr. 1, situata është e përmbysur kur i referehohemi kërkesave të administruara nga AP, ku kategoria e gazetarëve/mediave dhe OSHC përbëjnë vetëm **31%** (*thridhjetë e një*) të totalit. Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo prirje ka të bëjë kryesisht me faktin se qytetarët kanë si target kërkimin e informacionit dhe/ose dokumentacionit për çështje të karakterit individual, duke vënë në dukje njohurinë më të pakët të LDI në raport me kategoritë e tjera të kërkuarve. Kjo paradigmë është e shprehur edhe në cilësinë e ankesave, që administron institucioni dhe sidomos, në mënyrën e zgjidhjes së tyre, që në shifra përkthehet në një numër të papërfillshëm. Por në përmbajtje, kjo bashkësi rastesh përbën si peshë specifike thelbin e jurisprudencës së prodhuar në mbi një dekadë të veprimtarisë mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit në fushën e të drejtës për informim.

¹⁰<https://idp.al/raporte-vjetore/> - Raporti Vjetor 2024, fq. 13-14

¹¹ <https://idp.al/raporte-vjetore/> - Raporti Vjetor 2025, fq 14-15

Së fundi, por jo për nga rëndësia, AP iu dha mundësia të sugjeronin tematika për të cilat ka domosdoshmëri të përfshihen në trajnimet që zhvillon periodikisht Zyra e Komisionerit. Ndër më kryesoret prej tyre përmendim:

- proporcionaliteti rast pas rasti mes të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- bërjen e balancës mes legjislacionit mbi të drejtën e autorit apo të sekretit tregtar/patentat në raport me LDI;
- bërjen e testit të interesit publik kur kemi të bëjmë me trajtimin e çështjeve individuale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së AP;
- formën dhe mënyrën e publikimit të vendimmarrjes së AP;
- optimizimin e informacionit që publikohet/ndërlidhet në Programin e Transparencës, etj.

Zyra e Komisionerit është e bindur se një strukturë/organigramë funksionale dhe e kombinuar me ndarje të qartë të pozicioneve/detyrave për çdo nëpunës përkthehet në performancë të lartë të veprimtarisë së AP në zbatimin e LDI. Gjithashtu, përcaktimi ligjor, se përgjegjësia e çdo personi, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji, do të ketë në vazhdimësi ndikim pozitiv në arkitekturën e transparencës në tërësi dhe veçanërisht, në trajtimin në kohë dhe me cilësi të kërkesave për informacion. Megjithëse, situata është pozitive në këtë drejtim dhe ky konstatim është i prekshëm, është po aq e rëndësishme të pohohet, se ka ende vend për ta përmirësuar dhe forcuar atë, sidomos në optikën e procesit të integritetit evropian të vendit. Modernizimi i legjislacionit, standardeve dhe praktikave veçse forcon kulturën e transparencës së autoriteteve publike shqiptare.

PËRFUNDIME

Në frymën e transparencës dhe promovimit të saj, Zyra e Komisionerit vlerëson, se autoritetet publike shqiptare e kanë kaluar tashmë fazën e kuptueshmërisë së legjislacionit për të drejtën e informimit. Shumica e tyre e ka kthyer transparencën ndër objektivat parësore të performancës së duhur të veprimtarisë institucionale, përgjatë dekadës së fundit, në raport me qasjen e mbyllur dhe të ngurtë burokratike që jo rrallë konstatohet ende. Është e qartë, që ecja në këtë rrugë pozitive është rezultat i kombinuar i mirëfunksionimit të hallkave brenda strukturës organizative të AP, nivelit të lartë profesional, integritetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë, por edhe përmirësimit teknologjik në vazhdimësi. Në kushtet e sotme të ecurisë së zhvillimit ekonomiko-social të vendit, është e vështirë të kuptohet transparenca pa digjitalizimin.

Në terma konkretë, ky raportim ka ndikim të drejtpërdrejtë në aksesimin në të dhënat e koordinatorëve në portalin pyetshtetin.al dhe listën e AP në faqen zyrtare të institucionit, por edhe ato që mund të shërbejnë për kërkime më të specializuara shkencore për fushën e të drejtës për informim. Përmeshja e kuadrit rregullator në fuqi dhe krijimi i të gjitha kushteve për ushtrimin praktik dhe proaktiv të të drejtës individuale të çdo qytetari, veçse forcon mirëqeverisjen. Promovimi i kësaj qasje nuk mund të kuptohet pa bashkëpunimin, ndërveprimin e vazhdueshëm dhe në mirëbesimin mes Zyrës së Komisionerit dhe autoriteteve publike.

Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit beson se funksioni i saj trajnues është i rëndësishëm për të mbështetur zhvillimin profesional të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe/ose çdo nëpunësi tjetër të përfshirë në zinxhirin e transparencës. Edhe gjatë vitit 2026, Zyra e Komisionerit ka programuar një seri trajnimesh në mënyrë që të adresojë kërkesat e raportuara nga AP, për të garantuar rritjen konstante të njohurive mbi LDI. Zyra e Komisionerit vlerëson, se ky ushtrim i përvitshëm nxit përmirësimin në vazhdimësi të kulturës së transparencës së autoriteteve publike përballë qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Transparenca nuk mund të bazohet mbi perceptim, por në veprimtari të strukturuar në rregulla të qarta dhe të gjithëpranuara dhe jo thjeshtë në përmeshje mekanike e burokratike të tyre. Transparenca, padyshim, që është një mekanizëm dinamik në përmirësim, ku secili – nga nëpunësi me pozicionin më të ulët, e deri te titullari/drejtuesi i autoritetit publik, ka ndikim të drejtpërdrejtë. Transparenca mund të jetë një arkitekturë funksionale vetëm nëse është e projektuar si e tillë dhe LDI përbën themelin e saj. Zbatimi i tij, kombinuar me kuadrin ligjor në fuqi, përbën mjedisin për të kultivuar një demokraci të shëndoshë dhe mirëqeverisje efektive.